

Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K., është Institucion Mikrofinanciar i regjistruar në BQK, me mision që të siguroj qasje në shërbimet finaciare për individët me të ardhura të ulëta, në zonat rurale dhe urbane të Kosovës, me prioritet në sektorin e bujqësisë me qëllim që të influencojë zhvillimin e bujqësisë dhe aktiviteteve tjera ekonomike në zonat urbane.

Prandaj, Kreditimi Rural i Kosovës Sh.p.k rishpall:

K O N K U R S

Për rekrutim të **Një (1) Përgjegjës-e dege** për degën në **Kamenice**

Përgjegjësitë :

- Përgjegjes për krijimin dhe menaxhimin e portfolios se deges dhe te gjitha punet lidhur me aktivitetin kreditor,
- Përgjegjes për stafin dhe definimin prioriteteve për punën e tyre në përputheshmeri me procedurat e KRK-se,
- Kontribon në përpilimin e planeve strategjike të KRK-se.
- Merr pjesë në mbledhjet e komitetit kreditor të degës si anëtar,
- Përgjegjes për menaxhimin e aktiviteteve të marketingut dhe promovimit të ofertës kreditore,
- Analizon tregun në të cilën operon dhe identifikon nevojat për produkte të reja kreditore,
- Kontrollon kualitetin e të dhënave lidhur me kredit dhe respektimin e afateve për regjistrimin e kthimeve dhe shpërndarjeve të kredive në databazë,
- Koordinon punën në mes të degës dhe zyrës qendrore të KRK-se,
- Kontrollon kompletimin dhe sistemin e dokumentacionit lidhur me kredit dhe dokumentacionin financiar lidhur me shpërndarjen dhe kthimin e kredive, dhe
- Detyra të tjera që i caktohen nga menaxhmenti.

Kushtet e kërkuara:

- Diplomë universitare në ekonomi, bujqësi, etj,
- Përvojë paraprake në punë të ngjashme (e preferueshme),
- Njohuri të mira të punës me kompjuter, të njoh Windows Office dhe punën me baza të të dhënave,
- Shkathësi të mira të komunikimit dhe negocimit,
- Të jete dinamik, fleksibil, kreativ dhe i gatshëm për punë në ekip,
- Njohuri të gjuhës angleze (e preferueshme),
- Banor i komunës për të cilën konkurren (e preferueshme),
- Të posedoj patentë shofer për kategorinë B.

Konkursi mbetet i hapur nga dt. **08.03.2018** deri me dt. **14.03.2018**. Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë vetëm duke plotësuar aplikacionin në linkun: <http://krk-ks.com/vendepune/job-list?id=428>

Vetëm një numër i përzgjedhur i kandidatëve do të ftohet në intervistë.